

TERMAT E REFERENCËS

**Projekti: “Qasje e Përbashkët drejt Ekonomisë Qarkulluese Blu për Rajonin Adriatik dhe Jon” (JOINT approach to Blue circular Economy – for Adriatic and Ionian Region)
JOINABLE**

Thirrje për konsulencë: Konsulent për Shkencën Qytetare dhe Angazhimin e Komunitetit

Pozicioni: Konsulent për Shkencën Qytetare dhe Angazhimin e Komunitetit

Vendi i Punës: Nga shtëpia (me udhëtime të mundshme sipas nevojës në Bashkinë Divjakë dhe në terren për aktivitete me komunitetin)

Data e parashikuar e fillimit: 1 Gusht 2026

Data e parashikuar e përfundimit: 28 Shkurt 2027

Totali i Ditëve të Punës: Deri në 35 ditë pune për periudhën e projektit (të shpërndara gjatë periudhës së angazhimit dhe të dakordësuara me menaxheren e projektit)

1. Informacion i Përgjithshëm

Projekti JOINABLE është një nismë ndërkombëtare e bashkëfinancuar nga programi Interreg IPA ADRION, që bashkon nëntë partnerë nga gjashtë vende të ndryshme, si Itali, Kroaci, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Shqipëri dhe Greqi. Projekti synon të krijojë dhe të promovojë një ekonomi qarkulluese blu duke adresuar sfidën e vazhdueshme të mbetjeve detare dhe të ujërave të ëmbla në të gjithë rajonin Adriatiko-Jon.

Një nga shtyllat kryesore të projektit është angazhimi i qytetarëve dhe komuniteteve lokale në procesin e monitorimit, pastrimit dhe valorizimit të mbetjeve, duke i shndërruar ata në aktorë aktivë të ekonomisë qarkulluese. Bashkia Divjakë, si partnere e projektit, po kërkon një ekspert/kompani (të përmbledhur në termin konsulent) për të ofruar shërbimin e konsulencës në fushën e shkencës qytetare dhe angazhimit të komunitetit, me fokus të veçantë në ndërtimin e lëndës së parë të drejtuar nga qytetarët dhe në hartimin e raporteve përkatëse.

2. Objektivat e Detyrës dhe Përgjegjësitë

Objektivi i përgjithshëm i kësaj konsulence është të ofrojë ekspertizë për të mundësuar pjesëmarrjen aktive të qytetarëve dhe komuniteteve lokale në zinxhirin e vlerës së ekonomisë qarkulluese blu, duke siguruar që mbetjet e mbledhura nga mjediset ujore të shndërrohen në lëndë të parë të përdorshme për riciklim dhe prodhim.

Konkretisht, konsulenti do të kontribuojë në:

- Mbikëqyrjen dhe koordinimin e procesit të ndërtimit të lëndës së parë të drejtuar nga qytetarët (Aktiviteti 2.4), duke përfshirë vlerësimin e cilësisë së plastikës së mbledhur, testimin e vetive fizike, analizën e polimereve dhe përpunimin fillestar (përzjerje dhe grimcim).
- Hartimin e raportit të përbashkët ndërkufitar mbi mbetjet detare dhe të ujërave të ëmbla dhe lëndën e parë të përbërë (D.2.4.1), duke përmbledhur të dhënat dhe proceset e zhvilluara gjatë aktiviteve të angazhimit të komunitetit.
- Ofrimin e udhëzimeve dhe mbështetjes për stafin e Bashkisë Divjakë në organizimin e aktiviteve të monitorimit dhe pastrimit që përfshijnë qytetarët (në koordinim me Aktivitetin 2.2), duke siguruar që të dhënat e mbledhura të jenë të sakta dhe të përdorshme për analiza të mëtejshme.
- Kontributin në finalizimin e raporteve dhe materialeve të tjera që lidhen me angazhimin e komunitetit dhe shkencën qytetare, duke siguruar që ato të jenë në përputhje me standardet e projektit dhe kërkesat e programit.

3. Fusha e Punës dhe Produktet e Kërkuara

Konsulenti do të angazhohet për një total prej deri në 35 ditë pune gjatë periudhës Gusht 2026 – Shkurt 2027 (Periudha 5), me punën të shpërndarë si më poshtë:

Faza 1: Gusht – Nëntor 2026 (Periudha 5) – Deri në 20 ditë pune

Aktiviteti kryesor: Mbikëqyrja dhe koordinimi i procesit të "Building citizen driven feedstock" (Aktiviteti 2.4). Kjo përfshin:

- Vlerësimin e cilësisë së lëndës së parë plastike të mbledhur nga aktivitetet e pastrimit (pastërtia, nivelet e ndotjes, përbërja).
- Udhëheqjen e procesit të testimit të vetive fizike të plastikës (indeksi i rrjedhjes, forca në tërheqje, etj.) dhe analizën e polimereve duke përdorur teknika si spektroskopia në infra të kuqe (MIR).
- Koordinimin e përpunimit fillestar të lëndës së parë (përzjerja dhe grimcimi) për ta përgatitur atë për riciklim ose valorizim të mëtejshëm.
- Dokumentimin e të gjitha hapave dhe rezultateve të procesit.

Produkti i dorëzueshëm: Raport i ndërmjetëm mbi procesin e ndërtimit të lëndës së parë, duke përfshirë të dhënat e testimit dhe vlerësimet e cilësisë (material për raportin përfundimtar).

Faza 2: Dhjetor 2026 – Shkurt 2027 (Periudha 5) – Deri në 15 ditë pune

Aktiviteti kryesor: Hartimi i pjesës së Bashkisë Divjakë për raportin përfundimtar të përbashkët ndërkufitar mbi mbetjet dhe lëndën e parë të përbërë.

Produkti i dorëzueshëm: D.2.4.1 – Joint cross border report on marine and fresh waters litter and composites feedstock

Përshkrimi: Raporti do të përmbledhë të gjitha aktivitetet e ndërtimit të lëndës së parë të drejtuar nga qytetarët e Bashkisë Divjakë, duke përfshirë metodologjinë e përdorur, rezultatet e testimit të cilësisë, llojet e polimerëve të identifikuar, proceset e përpunimit dhe rekomandimet për përdorimin e lëndës së parë në prodhimin e produkteve të reja. Raporti do të shërbejë si bazë për rritjen e efikasitetit të burimeve dhe promovimin e ekonomisë qarkulluese në rajonin ADRION.

Afati kohor: Dorëzimi i raportit përfundimtar brenda muajit Shkurt 2027.

4. Kualifikimet dhe Eksperienca

Konsulenti duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

- Diplomë universitare (Master ose për lart) në Shkenca Mjedisore, Kimi ose një fushë tjetër e lidhur me menaxhimin e mbetjeve, riciklimin ose shkencën qytetare.
- Minimumi 5 vjet përvojë profesionale në fushën e shkencës qytetare, angazhimit të komunitetit në çështje mjedisore, menaxhimit të mbetjeve, ose fusha të ngjashme.
- Përvojë e provuar në organizimin dhe koordinimin e aktiviteteve të monitorimit dhe pastrimit të mbetjeve me pjesëmarrjen e vullnetarëve dhe komuniteteve lokale.
- Përvojë në analizën e cilësisë së mbetjeve plastike, testimin e vetive fizike dhe identifikimin e polimerëve (njohuri të spektroskopisë MIR ose teknika të ngjashme janë të dëshirueshme).
- Aftësi të shkëlqyera analitike dhe shkrimi, me përvojë në hartimin e raporteve tekniko-shkencore.
- Aftësi e lartë në gjuhën angleze (të shkruar dhe të folur) është e detyrueshme.

Përvojë të dëshirueshme:

- Përvojë pune në projekte të financuara nga BE, veçanërisht në programet Interreg ose Horizon.
- Njohje me ekonominë blu dhe menaxhimin e integruar të mbetjeve detare.
- Njohje e kontekstit socio-ekonomik të Shqipërisë dhe rajonit ADRION.
- Përvojë në trajnimin e grupeve të ndryshme të interesit (OSHC/OJF, vullnetarë, etj.) për përdorimin e mjeteve digjitale në monitorimin e mbetjeve.

7. Menyrat e aplikimit

Ekspertët konsulentë të interesuar janë të ftuar të paraqesin:

Për personat fizik konsulentë:

- a. Një CV të detajuar që thekson përvojën dhe kualifikimet përkatëse.
- b. Një propozim teknik që përshkruan qasjen ndaj detyrës (metodologjia për ndërtimin e lëndës së parë, përfshirjen e komunitetit, etj.).
- c. Një propozim financiar që tregon tarifën ditore në Euro (Oferta financiare - Aneksi A)

Për kompanitë e konsulencës:

- a. CV e kompanisë/ portofolit të shërbimeve të ngjashme.
- b. NIPT/ Ekstrakt QKB
- c. Një propozim financiar që tregon tarifën ditore në Euro (Oferta financiare - Aneksi A)

Data e parashikuar e fillimit të punës: 1 Gusht 2026

Afati i fundit për aplikime: 17 Korrik 2026, ora 23:59. Aplikimet pas këtij afati, nuk do të konsiderohen.

Nderkohe për pyetje, jeni të lutur t'i drejtoni deri në datën 08/07 Korrik, tek adresa: esmeralda.harizi@bashkiadivjake.gov.al.

Bashkia Divjakë do të kontraktojë ekspertin / kompaninë, oferta e të cilit është më e përshtatshme për projektin, sipas vleresimit të një komisioni specifik. Vleresimi do të realizohet sipas ndarjes:

<i>Fusha</i>	<i>Përqindja</i>
Edukimi dhe eksperiencat e mëparshme	70 %
Oferta financiare	30%

8. Raportimi

Eksperti do të raportojë drejtpërdrejt te Menaxheri i Projektit të Bashkisë Divjakë dhe do të punojë në koordinim të ngushtë me Partnerin Udhëheqës (Bashkia Punat) dhe partnerët e tjerë të projektit (veçanërisht VLPF dhe ETMI, të cilët kanë ekspertizë në shkencën qytetare). Përditësime të rregullta të progresit dhe takime koordinimi (virtuale) do të planifikohen për të siguruar përputhjen me afatet kohore dhe objektivat e projektit.

9. Financimi

Pagesa për shërbimin e kryer do të realizohet pas përfundimit të suksesshëm të shërbimit, në monedhën Lek, në llogarinë bankare të subjektit sipas dakordësisë dhe kushteve të vendosura në kontratën e lidhur me Bashkinë Divjakë.

10. Shënim

Për këtë ekspertizë preferohen kandidatët që operojnë në Bashkinë Divjakë ose që kanë njohuri të thella të territorit dhe komunitetit lokal. Ky dokument i Termave të Referencës bazohet në dokumentacionin e projektit të dhënë dhe mund t'i nënshtrohet rregullimeve në konsultim me konsulentin e suksesshëm dhe ekipin koordinues të projektit.